



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 09

Datë: 29. 01. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1.** Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
- 2.** Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.04 dhe 05/2021
- 3.** Aktivitetet e SKQZ-së
- 4.** Aktivitetet e ZRPPC-së:

-Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit për tërheqjen e shortit për radhitje në fletvotim

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

- 5.** Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për beartjen e votuesve nga QV 2133b - shkolla fillore "Dëshmorët e Qyqavicës" në fshatin Dashec në QV 2132 - shkolla fillore "Pavarësia" në fshatin Baks të komunës së Skenderajt,

Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit dhe zëvendësimeve për anëtar të KKZ-ve sipas komunave përkatëse,

6. Këshilli për Buxhet dhe Financa:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar i KQZ-se për vitin 2020 dhe

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të aditmit të brendshëm për vitin 2020;

7. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E hapim mbledhjen e 9 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur më rendin e ditës. Kryesuesi i këshillit për buxhet dhe financa më njoftoj që kjo pikë e rendit të ditës, më marrëveshje nga të gjithë anëtarët e këtij këshillit po të shtyhet për mbledhjen e ardhshme meqenëse nuk është i lidhur më afat ligjor. Sa i përket pikave tjera. A kemi ndonjë vërejtje?

Sami Kurteshi: Unë e pash rendin e ditës dhe pajtohemi me largimin e 2 pikave të raportimit të këshillit për buxhet dhe financa. Është një çështje e cila, nuk është futur në rend ditës dhe ajo është çështja e kërkesës së drejtorit të zyrës për regjistrim të partive politike. Ka dërguar një letër për trajtimin e saj. Unë mendoj se ajo, letër e ka vendin për diskutim në KQZ. Prandaj propozoj që ajo të futet në rend dite.

Valdete Daka: E kemi propozimin e Sami Kurteshit. Kush është që kjo letër të futet në rend të ditës për diskutim? Kush është për?

Alim Rama: Unë mendoj që nuk mundemi vetëm që të tejkalojmë, dhe kur është një shqetësim i një pjesëtari të KQZ-ës, duhet të trajtohet me vota për ose kundër. Kjo punë, nuk rregullohet. Ai ka shprehur shqetësimet e veta në atë email, jo që është ai i vetmi funksion që keni ndarë anëtareve të juaj që të arsyetohet por kjo nuk kalon ashtu vetëm me vota, ne me vota nuk mundemi më harru që dikush është kërcënuar këtu, e ka shkruar në email që është kërcënuar dhe mendoj që meriton të

shqyrtohet është dashur të vinte si propozim drejtpërdrejt për rend dite. Sepse me vota nuk e kishim trajtuar as çështjen, është tejkaluar çështja e aplikacionit për votim jashtë Kosovës, tani po e shohim së ku jemi dhe çfarë ka ndodhur këtu. Kështu që vetëm më vota kjo çështje nuk mundet të kaloj, mendojë që nuk është në rregull që gjithmonë ne vetëm më vota ti fshehim gjerat. Ka pasur një kërcenim këtu, ka qenë në publikë dhe është ky organ kolegjal i cili duhet të trajtojë këtë çështje.

Valdete Daka: Ne, kemi pasua edhe një kërcenim një letër tjetër e cila na është drejtuar gjithashtu nga stafi civil dhe e cila, po ashtu nuk do të trajtohet këtu sepse janë çështje të cilat nuk trajtohen dhe nuk është vendimmarrje e KQZ-ës, e cila i trajton ato. Ju lutem, mos t' i nxjerrim çështjet nga konteksti sepse madej, po dalim jashtë rendit. Ta ruajmë këtë institucion, i cili ka kohë që është shndërruar në foltore të subjekteve politike. Nëpërmjet të KQZ-së, politikat dhe programet nuk duhet të shpalosen. Ju kisha lutur që të përmbahemi të gjithë...! Në çiftë se konsideroni ju që po, ne i vendosim të dyja në votim...

Eshref Vishi: Unë, mendojë që duhet të fokusohemi në planin operacional të zgjedhjeve, ndërsa të gjitha pikat të rendit të ditës që nuk kanë të bërë më procesin zgjedhor t' i shtyjmë në një mbledhje tjetër.

Čemajl Kurtiši: Ju faleminderit. Mendoj që ne këtu nuk duhet të paraqesim qëndrime të partive politike. Pajtohem. Edhe unë jam përfaqësues i një subjekti politik, po unë nuk paraqes qëndrimet e saj. Ne, jemi institucion i pavarur, dhe duhet të përmbahemi. Dhe pajtohem me këtë. Këtu, nuk guxon të ketë kurrfarë kërcënimesh pavarësisht se për cilën parti bëhet fjalë. Nuk guxon të ketë këso raste, ky institucion i pavarur duhet të mbrohet...

Sami Kurteshi: Unë megjithatë zonja Kryesuese nuk pajtohem më fjalimin e juaj së partitë politike po fryjën këtu dhe po i qesin platformat politike, ne në asnjë moment nuk i kemi qitur platformat politike sepse ne duhet të punojmë sipas ligjit edhe sipas rregullores dhe unë pajtohem plotësisht që kjo duhet të ngjaj edhe asgjë tjetër. Nëse është kjo rregullore që është në fuqi dhe po vlen, ne jemi të gjithë përfaqurës të partive politike dhe ne kemi drejt që ti bartim kërkesat e parive politike në KQZ dhe jo më e shndërruar KQZ ne platforma të partive politike. Nëse rregullorja thotë se 4 anëtar të KQZ kanë të drejt me e ftuar, me thirr një mbledhje të kryesisë dhe kryesuesja e KQZ-së nuk e thirr një mbledhje është shkelje e rregullores ? Po. Nëse ky institucion merr vendime. Dhe ka marr vendime dhe kundër disa partive politike, me vota nuk janë të specifikuar listat e disa partive politike edhe në mesin e tyre vetëvendosja, dhe ky ka qenë vendimi prej nga e drejta që PZAP-ës të i dërgohen letrat më propozime nga kryesuesja se si duhet të vepohet pa marr vendim KQZ-ja. Ky trup ka vendosur s' i ka vendos, nuk kanë kaluar listat e parive politike! Kush ka propozuar që të behet një selektim: propozojmë që listat të miratohen po këta persona mos me qenë. Këtë vendim, nuk e ka marr KQZ-ja. Kush i ka shkruar ato

letra? Nëse ju i keni shkruar znj. Kryesuese kjo nuk është bartje e platformës politike por kjo është shkelje e ligjit dhe e rregullores, nëse nisemi nga ligji përgjithshme, funksionet dhe përgjithësitë kryesuesja dhe asnjë anëtar i KQZ-së nuk ka të drejtën më ju drejtua institucioneve tjera në emër të KQZ-ës pa marr vendim KQZ-ja. Nëse këtë detyrë e paska sekretariati apo zyra për regjistrimin e partive politike, a i kanë dërguar ata këto letra, nëse nuk i kanë dërguar ata këto letra, kush ka dërguar në emër të KQZ-ës, unë nuk kam qenë i informuar po ashtu dhe anëtarët tjerë nuk kanë qenë të informuar. Ne nuk po kërkojmë shtjellimin e platformave politike të partive politike absolutisht jo. Po kërkoj drejtpërdrejtë zbatimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme zbatimin e rregullores së punës së KQZ-së...

Ibrahim Selmanaj: Ne, jemi në që kemi para vetës një rend ditë, në të njëjtën kohë jemi subjekte politike dhe përfaqësues të subjekteve politike që në rastin konkret disa nga lista nuk janë certifikuar dhe ajo e ka një rezultat që neve na prek dhe një farë forme na hup fuçinë elektorale dhe nuk e kemi një rezultat që edhe nuk kemi guxim të ndërhyrë sepse veç është bartur në institucionet tjera, momentin që veç kemi parashtrua një ankesë dhe presim prapë rezultatin, nuk qohemi me paragjykimë së cili do të jetë vendimi i Gjykatës Supreme. Unë, jam kategorik që nuk duhet të fyejmë sepse kjo për fat të keq është përsëritur më 10 herë edhe ne prezencën e mediave po edhe në prezencën tonë, unë prapë mendojë që nuk është momenti më i mirë sot që të lëshohem në këtë temë. I kemi dy kërkesa që janë të parashtrua dhe mendojë që duhet të shkojmë më rendin e ditës, sepse dhe ashtu kemi shumë tema para vetës dhe e kemi afatin e shkurtuar por si do që të jetë kërkoj mirëkuptim nga të gjithë në këtë situatë që jemi, në të njëjtën kohë kërkoj edhe apeloj që Gjykata Supreme ta merr vendimin i cili është në favor të të drejtës. Të jemi të kujdesshëm në raport më njeri tjetrin dhe ta dërgojmë vetëm çështjen përpara sepse shumë i kemi ditët e shkurtuara...

Alim Rama: Nuk pajtohem që kemi afate të shkurta dhe jemi në proces zgjedhor. Por, unë ja kam dërguar kërkesën mbledhjeve nga KOZ-i, për një çështje teknike nga data 25-26 dhe ju, nuk e keni pa në rregull që ne të i përmbushim këto afate ligjore. Kanë qenë çështjet më planet operationale. Afati i fundit për plotësimin e KKZ-ve, ka qenë më 25. Në KOZ e kemi trajtuar këtë çështje më marr vendime për rekomandimin në KQZ të cilat është dashur që ti trajtojmë dhe ju nuk i keni ftuar në mbledhje znj. Kryesuese. Kjo në një farë mënyrë është uzurpimi i funksionit të cilin e bartini si Kryesuese pra ky është ai problemi. Përveç shkresës që e ka përmendur z.Kurteshi, ju vetë jeni përgjigjur në shkresat në PZAP, ose dikush nga zyra që ne e kemi konfirmim. ZRPP nuk i ka bërë ato, po ashtu edhe arsyetimet që nuk kanë qenë të votuara në KQZ, në KQZ lista e vetëvendosjes nuk ka marrur vota të mjaftueshme për certifikim. Arsyetimet kanë qenë arbitrare dhe nuk janë votuar në KQZ dhe nuk kanë qenë të shkruara nga zyra. Kjo, është një shkelje e pozitës që keni dhe kjo, është shumë shqetësuese. Keni penguar

zbatimin e planit operacional, keni bërë shkresa në mënyrë autonome, sepse ato shkresa nuk janë votuar në KQZ...

Valdete Daka: Asnjë shkresë asnjëherë nuk është votuar në KQZ. Shkresat që i nënshkruaj unë, draftet të cilat më i dërgoni i kontrolloi sepse, duhet që t'i nënshkruajmë vetë dhe e barti përgjegjësin vetë. T'i, hiq mos u mërzit sepse unë e barti përgjegjësin për çdo gjë që unë kam nënshkruar. Unë e barti përgjegjësin edhe penale edhe morale për të gjitha shkresat që i nënshkruaji sepse, e shikoi çfarë kam nënshkrua. Jo çdo shkresë që me dërgohet nënshkruhet pa u pa! Përderisa nënshkruaj, kam të drejtën të nënshkruaj me ligj dhe me kushtetutë: do t'i shikoj dhe do t'i nënshkruaj sepse, janë draftet të cilat me dërgohen. Dhe po të lutem që nëse bën, të vazhdojmë me rendin e ditës...

Sami Kurteshi: Nëse ju konstatoni se paska sulme personale ndaj jush nga ne dhe këto që po i ngritëm ne nuk qenkan çështje të KQZ-ës sipas ligjit dhe sipas rregullores dhe se vendimet e KQZ-ës, po u mundkan me u nënshkruar në emër të KQZ-ës, pa miratimin e KQZ-ës atëherë këtu paskemi punë më një çështje tjetër. Ju keni drejt të e përfaqësoni KQZ për çështje teknike por për vendime që prekin përmbajtjen qoftë të partive politike apo të sjelljes, apo vendimeve që kanë një rendësi nuk është më ligj e rregulluar dhe nuk është bartur kjo kompetencë. S'i kryesuese, mund të shihni funksionet dhe përgjegjësit e KQZ-së. Ju lutem mos i keqpërdorni në këtë formë, ne këtu nuk po diskutojmë për çështje personale, nuk ka asnjë fyerje, asnjë sulm ndaj jush as personal. Ne, asnjë çështje personale nuk e kemi ngritur, asnjë nuk është çështje e imja personale...

Valdete Daka: A e keni dërguar shkresën në PZAP? PZAP-ja është organ me i lartë se ne, dhe ajo vendos lidhur më çështjet për të cilat ju jeni ankuar. PZAP-ja vendos është dhe Gjykata Supreme, ju i keni dërguar të gjitha shkresat, ata madje tregojnë nëse nuk kam pasur kompetenca apo kam pasur kompetenca dhe të gjitha. Ata i kanë këto shkresa, ju lutem që t'i lejojmë le të marrin vendime organet.

Sami Kurteshi: Ne po pyesim kush i ka dërguar në emër të KQZ-ës, arsyetimet ata mundën të marrin çfarë do vendimi dhe në ato vendime në kemi të drejtën e shtjerrës e mjeteve ligjore. Mirëpo në emër të KQZ-ës, shkojnë shkresa që përfaqësojnë pikëpamjen e KQZ-ës pa një vendim të KQZ-ës, kjo është çështja.

Valdete Daka: Kush është për këtë rend të ditës? Kush është kundër? Kush abstenon? Vazhdojmë...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.04 dhe 05/2021

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratimin e procesverbaleve nga mbledhjet numër 4 dhe 5 . A ka dikush vërejtje në këto procesverbale. I kemi pasur që një kohë në email. Nëse nuk kemi vërejtje. Kush

është për miratimin këtyre procesverbaleve? Miratohen. Vazhdojmë me piken tjetër, aktivitete e SKQZ-ës.

3.Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj: Sekretariati është në fazën përgatitore për përgatitjen e zgjedhjeve të cilat do të mbahen më 14 shkurt, aktualisht fokusi me i madh është në periudhën e aplikimit dhe regjistrimit të votuesve jashtë vendit pa i anashkalluar dhe aktivitetet tjera përgatitore për organizimin e zgjedhjeve. Sekretariati është duke punuar në shumë dimensionë më qellim të organizmit të zgjedhjeve dhe furnizimit më materiale zgjedhore. Duke ju referuar periudhës së aplikimit dhe regjistrimit të votuesve jashtë vendit konfirmoj se procesi i hapjes së imellave dhe printimit të imllave për secilin aplikues është përfunduar dhe tash në jemi në fazën e procesimit të dhënave dhe të gjitha këtyre aplikuesve që kanë aplikuar për të votuar, procesi i cili konsiderojë që do të përfundoi sot gjatë ditës dhe pastaj për të pasuar më operacione apo më procese tjera që është vlerësimi i zotësisë juridike të gjithë aplikueseve që kanë aplikuar për të votuar jashtë vendit dhe procesi i fundit që është verifikimi përmes kontaktimit apo përmes thirrjeve telefonike e secilit votues i cili fiton të drejtën për te votuar. Nga shifrat aktuale në këtë proces që akoma nuk është i përfunduar mirëpo rezulton se janë: 174.258 aplikues të cilët, kanë aplikuar përmes email-it deri me tani. Po sa të përmbillet ky proces i regjistrimit të dhënave do ta kemi edhe shifrën e saktë se sa votues kanë aplikuar përmes postës. Nga këto të dhëna vlerësimin zotësisë juridike është bërë 63.511 aplikues që ne përqindje i bije diku rreth 36.44% të aplikacioneve.

Pra, nga 63.511 aplikues të vlerësuara prej tyre të konfirmuara janë 52.548 aplikacione, ndërsa në statusin e refuzimit apo në pritje për refuzim në qoftë që aplikuesit nuk sjellin dokumentet e kërkuara 10.963 aplikacione, pra rastet më të mëdha të refuzimit janë sepse një pjesë e votuesve kanë dërguar vetëm aplikacionet pa ju bashkangjitur edhe dokumentet tjera të kërkuara, kjo është pjesa më e madhe e arsyeve të refuzimit, kemi kërkuar sqarime shtesë jemi në proces dhe besojmë që procesi i regjistrimit të dhënave do të përfundoi sot dhe deri nesër do të mundemi ta kemi të përfunduar edhe procesin e regjistrimit apo vlerësimin e zotësisë juridike dhe në mënyrë progresive, pas këtij procesit jemi duke punuar edhe me thirrjen e të gjithë aplikuesve të cilët kanë aplikuar e kanë statusin e konfirmuar dhe po ashtu ju kemi kthyer thirrjeve të gjithë atyre votuesve të cilët për arsye të ndryshme nuk ju kanë përgjigjur thirrjeve nga KQZ-ja. Prej tyre dje rreth 1000 votues ju kanë përgjigjur thirrjeve kjo është mbledhur nga të gjitha ditët që kemi thirrur deri me tani. Deri me tani janë realizuar 45.170 thirrje telefonike, prej tyre 36.685 aplikues janë përgjigjur thirrjeve telefonike dhe kemi konfirmimin e tyre. 61 aplikues kanë deklaruar që nuk janë persona sipas të dhënave që janë nxjerrur nga data baza e shënimeve ose kanë deklaruar që nuk kanë aplikuar personalisht. Ndërsa, 7256 aplikues akoma

nuk ju kanë përgjigjur thirrjeve mirëpo në mënyrë progresive jemi duke punuar që të kontaktimi edhe këta votues të cilët për arsye të ndryshme ndoshta nuk ju kanë përgjigjur thirrjeve, mirëpo do të bëjmë tentime deri në ditën e diel që t'i kontaktimi të gjithë dhe pastaj pasi të përmbillen të gjitha proceset dhe pasi të përmbillen të gjitha tentimet atëherë do ti japim edhe mundësin aplikuesve të cilët nuk e kanë të konfirmuar ti japim mundësin të na thërrasin në numra të telefonit në qendrën e thirrjeve.

Pra, shprehur në përqindje deri më tani 81.35% të thirrjeve janë realizuar. Sa i përket përgatitjes sekretariati jemi në fazën e përgatitjes të furnizimeve dhe shërbimeve, dhe jemi duke ecur në bazë të planit operacional, sigurisht që jemi në fazën e përgatitjes së nominimeve të këshillave të vendvotimit, ndërsa faza e parë e trajnimit e trajnerëve është përfunduar dhe jemi në përgatitje për trajnimin e këshillave të vendvotimeve. Këto pak a shumë janë operacione apo përgatitjet e sekretariatit për organizimin e zgjedhjeve dhe nëse keni pyetje jemi të gatshëm të përgjigjemi rreth organizimit të zgjedhjeve.

Eshref Vishi: Kam një pyetje për Kryeshefin ekzekutiv, ju në raport keni saktësuar periudhën e votimit jashtë vendit nga 13 deri 21 2021 në orën 18:00, pas kësaj date kemi disa reagime të bashkatdhetarëve për arsye që nuk ju ka mundësuar, mundësia e aplikimit deri në këtë datë dhe në orën 18:00, unë kam disa argumente që në orën 17:12 është bërë aplikimi mirëpo nuk ka pas qasje në ueb-faqe dhe ju ka mohuar e drejta, çfarë do të behët në këto raste dhe a ka mundësi që të rregullohet kjo çështje, që deri në orën 18:00 të pranohen aplikimet.

Burim Ahmetaj: Kemi pasur ankesa edhe në email-in që është për të gjithë votuesit po ashtu për këtë arsye kemi edhe ankesa në PZAP lidhur me votuesi të cilët nuk kanë arritur të votimin në kohën e caktuar pra kur është bërë edhe përmbyllja, mirëpo konsiderojmë se ka qenë çështje e internetit, rrjeti, kështu që KQZ-ja ka deklaruar në orën 18:00 ka bërë edhe përgjigjen automatike, mirëpo pse nuk kanë ardhur deri në atë kohë email-at është çështje e rrjetit d.m.th është çështje më shumë teknike, për këtë kemi edhe ankesat e votuesve sigurisht që i kanë adresuar edhe në PZAP dhe pasi të vijën vendimet nga PZAP-ja sigurisht që sekretariati përmes KQZ-ës do ti ekzekutoi të gjitha ato vendime që do të vijnë. Por si do që të jetë kemi pasur ankesa jo në numër shumë të madh por ankesa një numër të vogël që nuk kanë mundur të shfrytëzoni aplikimin në kohën e caktuar.

Sami Kurteshi: Unë kam disa pyetje më çështjen që e ngriti z.Vishi. E kemi ngritur edhe në mbledhjen e kaluar, kemi pasur raste kur është dërguar kërkesa për aplikim ose aplikacioni në orën 16:00 e disa minuta, në orën 17:00 e disa minuta i është kthyer përgjigja negative d.m.th se është mbyllur, dhe të dyja e krijojnë një paradoks sepse përgjigja për refuzim është kthyer para orës 18:00. Unë kam disa kërkesa tjera. Ju thatë që janë 174.000 aplikues, ndërsa nga raportet që na janë dërguar 164.000 email-e për afërsisht. A do të thotë që numri i aplikuesve më i madh se 164.000 email-e. Çështja tjetër

është nga rrjedha e veprimeve dhe për hapjen e të gjitha aplikacioneve po duket se do të tejkalohet afati për ankesa. A do të mundeni që ti ofroni njerëzve që kanë ankesa të rastit nuk e di çfarë? P.sh një pjesë e tyre nuk i kanë dërguar dokumentet e kërkuara, duhet të dërgoi një flet dëshmi a?

Nëse ai i dërgon dhe nuk i konfirmohet pranimi i këtyre ankesave dhe ai madje i refuzohet, si do të jetë më aftin e ankesave, a do të tejkalohet ky afat i ankesave, a do të arri sekretariati me numrin e njerëzve që ka me mundësit teknike që i ka me e plotësuar kërkesën aq të madhe të njerëzve që kanë aplikuar dhe te ju ofrohet një mundësi në rast që sigurisht nuk janë shumë, po në rast të ndonjë shkelje ku ata kanë të drejtë...

Burim Ahmetaj: Sekretariati, është tani në një fazë tjetër që ka konfirmuar që të gjitha email-at janë të hapura, mirëpo nuk është përmbyllur akoma ky proces sepse jemi në fazën e regjistrimit e të gjithave këtyre aplikacioneve, të kemi kujdes se në secilin aplikim ta printomi dhe të regjistromi ne data bazë, numri prej 174.258 nuk mundemi ta konsiderojmë që është final sepse jemi akoma ne procesim, kemi pasur shumë të dhëna dhe besojmë se gjatë ditës do të dimë numrin e saktë të të gjithë aplikuesve, kështu që akoma jemi në përpunimin e dhënave dhe këto janë të dhënat preliminarë nuk i kemi përfundimtare. Mund të jetë por sa do jetë në raportimin tjetër në KQZ, do të mundemi ta dimë sot. Ndërsa sa i përket aplikuesve ju kemi kërkuar për plotësimin e dokumenteve jemi në pritje të këtyre dokumenteve, ju kemi kërkuar secilit individualisht se çfarë dokumente ju kërkohet dhe në rast që deri te dielën nuk e kthejnë sigurisht jemi afër fazës kur duhet të bëhet edhe certifikimi i listës përfundimtare votuese që ndërlidhet edhe me listën e votuesve jashtë vendit.

Ne, pafundësisht nuk mundemi të presim por si do qoftë i kemi kthyer email të gjithë këtyre aplikuesve ju kemi kërkuar dokumente të caktuara dhe në rast që nuk i sjellin sepse përmbyllen shumë operacione, sot pritet të përmbyllet operacioni i regjistrimit i votuesve në data bazë, menjëherë në të njëjtën kohë fillojmë edhe me vlerësimin zotësisë juridike, kështu që kur përmbyllen këto 2 operacione ndoshta përmbyllet edhe pjesa e kthimit të përgjigjeve apo dokumenteve të kërkuara për secilin aplikues dhe sigurisht në mënyrë progresive. Të gjithë votuesit që fitojnë zotësinë për tu regjistruar si votues jashtë vendit, në mënyrë progresive i dërgomi në qendrën e thirrjeve për ti thirrur të gjithë ata. Kështu që i kemi proceset e ndërlidhura mirëpo konsideroi që shume shpejt do ti përmbyllem këto afate në mënyrë që potencialisht të dielën ti japim mundësi atyre që nuk e konfirmoni përmes telefonit apo nuk kemi mundur të qasemi përmes telefonit, ti japim të paktën një periudhë ku ata do mund të na thërrasin neve në telefon më qellim të konfirmimit. Pra, këto janë planifikimet e sekretariatit mirëpo nuk mundemi të presim pafundësisht nëse nuk na kthejnë email-in.

Burim Ahmetaj: Sipas parashikimeve konsiderojmë që sot do të fillimi më zotësinë juridike dhe konsideromi që deri nesër paradite ta përmbyllem procesin e vlerësimit të zotësisë juridike, që në

mënyrë progresive çfarë procesohet dhe fiton zotësinë juridike do të dërgohet në qendrën e thirrjeve. Sipas planifikimeve preliminare konsideroi që dita e diel do ti jepet hapësirë të gjithë votuesve për të kontaktuar në numrat e telefonit në KQZ, deri në atë kohe do të mundohemi që ti përfundimi të gjitha thirrjet nga lista e data bazës. Kemi filluar dje që ti thërrasim të gjithë ata persona të cilët nuk ju kanë përgjigjur thirrjeve telefonike dhe kemi progres në këtë aspekt sepse e kemi diku rreth 1000 votues të cilët ju kanë përgjigjur thirrjeve telefonike. Mirëpo sipas planifikimeve preliminare mund të jetë dita e diel kur mund që të i jepet hapësirë të gjithë votuesve për të kontaktuar në KQZ, për ta verifikuar apo konfirmuar përmes telefonit.

Sami Hamiti: Vlerësimi i zotësisë juridike e kemi 63.000 aplikues. A ke keni shikuar në këtë 63.000 a ka aplikacione të dyfishta? Që e kemi konsideruat zotësinë, d.m.th nuk i keni pastrua email-at për ato që janë dyfishte sepse duhet është për opinionin, 174.000 email-a, keni aplikime të dyfishta, trefishta dhe të pesëfishta, sepse ka persona që i ka dërguar në 3 email-at, pra edhe në 63.000 ka email-a të dyfishtë, ju kisha lutur sa më shumë që ti shtoni kapacitete që te i futni sa me shpejt dhe zotësinë juridike ta tregoni vlerësimin dhe që ti pastroni aplikuesit e dyfishtë, dhe besoj që nuk dalin këto shifra.

Edhe unë, kam vrenjtje për këta persona që e kanë dërguar email-in në ora 15:00, 16:00 dhe ka arritur më vonës, unë kam biseduar më zëvendës-kryeshefin për këtë çështje se ai email ka arritur disa orë më vonës dhe është refuzuar, dhe duhet të bëjmë krekës në PZAP le ti shtjellon që të kthehen në listë. Pjesa tjetër e cila nuk është lajmëruar e sidomos ata që janë lajmëruar që nuk janë aplikues d.m.th nuk kanë aplikuar vetë, atë regjistër kemi nevojë ta shohim të saktë dhe të dihet që të qohet në prokuroi që të dihet së kush ka aplikua për ata, pse ka aplikuar. Po ashtu, email-at e përbashkëta ku janë shkuar me qindra aplikacione duhet me i pa sepse, ato aplikacione duhet të na njoftoni në KQZ! Dihet saktë se, cili është vendimi për ata votues, munden më qenë familjar, një aplikacion mundet më qenë në një adres dhe më një mbiemër të njëjtë.

Čemailj Kurtiši: Unë falënderoj kryeshefin dhe sekretariatit që, tani kemi edhe komunikimin në gjuhën boshnjake. Ju falënderoj, sepse ka pasur probleme, por besoj që shërbimi do të jetë efikas, dhe do t'iu mundësoj të gjithëve votimin...

Rifat Krasniq: Keyeshef shumë faleminderit për atë person që e keni pranuar këtu më kontaktua në Turqi, sepse i kemi afër 800 aplikues dhe çdo ditë janë duke thirrur. Prapë po ju falënderoi që i keni pranuar një zyrtar këtu me bisedua me ata. I falënderoi anëtarët e KQZ-ës shumë që, e kemi rregulluar ligjin në gjuhën turke. Tani, komunat që janë më komunitet turk që jetojnë në Kosovë dhe ligjin që e kemi rregulluar, nga data që e kemi bërë ligjin, formularët nga sot me qenë në gjuhën turke, do të doja që ti them edhe disa fjalë në gjuhën turke sepse janë duke na shikuar edhe nga Turqia...

Alim Rama: Kemi një konstatim: janë të refuzuara dhe ky konstatim nuk vlen asnjë aplikacion ende nuk është refuzuar dhe ky mesazh duhet të jetë i qartë deri sa nuk përfundon procesi. Po ashtu edhe pse ju bashka ngjitemi kërkesave të kolegeve me herët që i kanë përmendur duhet që të rriten kapacitete, kjo krekës është vazhdimisht që disa ditë, ne vetëm i kemi kaluar disa afate ato që i përmendi z. Kurteshi, koha e ankesave, koha e shpalljes së sfidimit të listave ka qenë prej 25-27 janar, ky afat nuk është respektuar nga KQZ-ja. Realisht ne si KQZ kemi dështuar për ti përmbushur këto afate, ndërkohe po vjen një farë mënyre si e pas unë prezantimin më herët, penalizmi i votuesve për mos kryerjen e punëve së KQZ-ës apo sekretariati në veçanti sepse afati për sfidomë ka qenë prej 25-27 janar, ai është afati ligjor i aprovuar nga KQZ-ja, në mbledhjen kur është aprovuar edhe plani operacional. Tani unë kisha qenë shumë i kujdesshëm më këtë ashpërsi të tonit sepse ata që nuk konfirmohen deri të dielën kisha lutur sekretariati është njëherë që të i ndërmarr të gjitha masat që secili person të kontaktohet, të hetohen dhe ata persona që kanë than që nuk kanë aplikuar vetë më ata duhet që të merret prokuroria ashtu edhe ka qenë vendimi ata janë 61 persona. Kur është një proces e sipër mundet me pas edhe dyfishime, mundet me pas ende dokumente që të vlerësohet zotësia juridike.

Për këtë, unë fillova me ato 11.000 aplikacione të refuzuara sepse, është konstatim shumë i gabuar, ky është një dokument zyrtar që e kemi pranuar, kështu që kisha kërkuar që në mbledhjet e radhës që kjo timologji mos të përdoret, ata refuzohen vetëm në momentin kur certifikohet lista, ata janë ne proces të kërkimit të dokumenteve dhe këtë e kam ngritur si çështje po ashtu edhe ne mbledhjet e kaluara. Se kjo po i bije që ne si institucione kemi të drejt që të i luajmë afatet por qytetaret jo. Në vend që ne te bëjmë gjithçka që të gjithë afatet të respektohen... nga këto raporte neve na dalin që diku 81% që nuk janë përgjigjur në telefon sepse kanë probleme tjera apo nuk janë ne gjendje që të përgjigjen, ky proces deri më tani na tregon që 0.1% kanë konfirmuar që nuk kanë aplikuar vetë apo dikush ka aplikuar për ta dhe më ato raste duhet të merret prokuroria. Ne kemi kërkuar shumë kohë që ky aplikim të automatizohet në proces më herët, ne jemi në fund të procesit kemi shpenzuar më dhjetëra mija euro vetëm në letër ku ky proces ka mundur me qenë automatik. Kështu që, e kisha njoftuar KQZ që të jetë e kujdesshme në vendimet që ajo merr dhe vendimet kanë pasoja sepse ato duhet të realizohen.

Eshref Vishi: Është e njëjta temë që po e shtjellonin edhe koleget, megjithatë ne jemi shumë të vetishëm sepse është proces me angazhim enorm dhe sfidues, unë mendoj që administratës i duhet përkrahje dhe i duhet bashkëpunim në mënyrë që ti përmbush afatet e caktuara në plan operacional janë afate të shkurta që e thash edhe pak me herët po ashtu dhe sfiduese, për arsye që ende nuk ka arritur % më shkuar krahas afatit që ka para vetës, në raport evidentohet së mbi 100.000 aplikacione janë ende të pa verifikuara dhe sa i përket zotësisë juridike, administrata duhet që ta ketë parasysh

për verifikim dhe unë mendojë që varësisht nga kapacitete kategorike që janë të angazhuara dhe administrata duhet që të ketë parasysh që nëse edhe duhet të shohin këto kapacitete në mënyrë që të përmbushen këto afate me kohë.

Valdete Daka: Ndoshta, është dashur me tepër me ju dërguar mesazh bashkatdhetarëve tan, që jetojnë jashtë Kosovës që të mos i dërgojnë nga 3 email-e apo nga 5, sepse KQZ-ja shumë qartë e ka treguar që çdo email do të shqyrtohet dhe çdo email është shqyrtuar dhe është futur në data bazë. Tani sa për të sqaruar për publikun sepse po manipulohet më numra dhe shifra është shumë me rendësi që të dimë saktë sa janë votues të vërtet, sa emra janë nga një, jo nga 3, nga 4, nga 5, si e kemi informatën nga sekretariati se shumë nga këto email-a janë dyfishta, kështu që kjo informatë na duhet e saktë sa më parë edhe për shkaqe të publikut mos të krijohet precesioni që pastaj po u refuzohen pa të drejtë apo po behët ndonjë situatë e cila madje i dëmton ato, pra na duhet sa më parë ta dimë, dhe e kisha lutur stafin teknik që brenda ditës ta kemi informatën së sa janë votues të dyfishtë, sa është numri real i votuesve. Nëse nuk mundeni sot duhet që nesër brenda ditës që ta dimë saktë sa është numri i vërtet i atyre që janë votues, pastaj a e kanë zotësinë juridike apo jo është edhe një çështje tjetër, mirëpo çështja e parë është që ta dimë sa janë vërtet që kanë aplikuar, jo që kanë aplikua 3 herë apo 2 herë.

Burim Ahmetaj: Sqarimi i fundit këto të dhëna që i kemi janë preliminare nuk janë përfundimtare sa për informacion, pra nuk mundeni të jenë të sakta sepse ne do të bëjmë kontrolle të vazhdueshme në mënyrë që ti përmbyllim të gjitha, konsideromi që jemi shumë afër përmbylljes së fazës së parë të regjistrimit të gjithë aplikuesve të cilët kanë votuar në data bazë, në momentin që regjistrohen këta pastaj do të përmbyllim edhe procesin e vlerësimit të zotësisë juridike. Këto shifra që janë në secilin operacion apo në secilin aspekt nuk pasqyrojnë vlerë reale sepse janë preliminare, kështu që pasi të përmbyllet do ta kemi shifrën e saktë dhe do ta dimë se sa votues kanë aplikua dhe e kanë të drejtën e votës, po ashtu do ti eliminomi të gjitha aplikime e dyfishta apo të trefishta në mënyrë që ti kemi shifrat e sakta dhe do ti kemi vlerat përfundimtare.

Në përjashtim të kësaj, asnjë herë nuk jemi ndalur sa i përket qendrës së thirrjeve, në mënyrë progresive kemi punuar deri me dje kemi punuar 24 orë në përkrahje të këtij shërbimit, tani jemi në një fazë ku kemi fillua intensitetin e punëve dhe disa punë vetëm kan filluar të përfundojn dhe do të ule edhe intensiteti i punëve në mënyrë që të finalizohet ky proces. Është e vetët ajo që e potencoi Z.Rama se 10.000 aplikacione nuk janë të refuzuara jemi në statusin e pritjes për të sjellë dokumentacionet tjera, pra mos të vlerësohet që janë 10.000 refuzime sepse pasi që të kompletohen apo nëse arrin që të i sjellin dokumentet që janë kërkuar nga sekretariati atëherë do ta marrin edhe statusin varësisht prej dokumenteve që ata sjellin. Do ta bëjmë këtë përmisim i cili është në çështje

terminologjike mirëpo deri me tani nuk kemi asnjë aplikus që është refuzuar. Por konsideroi që nesër gjatë ditës të kemi në raportimin tjetër të radhës dhe të kemi shifra më të sakta, do të kemi vetëm edhe 2 operacione , kemi vetëm vlerësimin e zotësisë juridike dhe thirrjet sepse hapja e email-eve vetëm që është përfunduar dhe regjistrimi në data bazë sot pritet të përfundoj dhe jemi vetëm edhe në 2 operacione.

Valdete Daka: Unë e kisha falënderuar stafin të cilët kanë punuar nga 24 orë në këtë operacion i cili ka qenë operacion jashtëzakonisht i vështir dhe ka kërkuar vëmendje të stafit dhe të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë aty, besojë që do të arrijmë që të përfundojmë, ndoshta herëve tjera unë shpresoj që mos të ketë mbledhje të jashtëzakonshme po në qoftë që kemi ndonjëherë kësi lloj të zgjedhjeve kishte më qenë mirë që sekretariati kur e përpilon planin operacional që të i ketë parasysh sepse u akuzuan tash që kemi tejkaluar, është e vërtet mirëpo askush nuk e ka parashikuar se do të kemi një numër aq të madh të aplikimeve dhe sidomos këto që kanë qenë të dyfishta të cilat e kanë ngarkuar procesin dhe më shumë, prandaj edhe nuk është arritur që ndoshta të përfundoj deri në fund gjithë ajo që është paraparë me ligj dhe në planin operacional prandaj dhe i kemi ato mësimet të nxëna sepse duhet të kemi parasysh edhe mundësit fizike po ashtu dhe teknike të cilat i ka sekretariati.

Alim Rama: Ju vetë e keni potencuar që ka të dyfishta dhe të trefishta, unë ju kisha lutur juve dhe të gjithëve anëtareve të KQZ-ës që të i lexoni raportet se si janë, raporti thotë të dhënat janë preliminare mundet më pasur dyfishime por s' duhet që të ketë potencim që secili email... janë 150.00 email-e ku secili email ka mundur të ketë nga 2 apo 3 aplikacione, për ata nuk është mirë të flasësh email-e të dyfishta apo trefishta sepse po përçoni një mesazh të gabuar, mesazhi është i qartë raporti është i qartë i sekretariatit, përdorni numrat si i kanë dorëzuar, rezultatet preliminare janë futur në sistem 65.000 janë në proces të verifikimit të zotësisë juridike, 52.000 janë konfirmuar nga zotësia juridike. Këto janë fakte dhe thirrjet që janë bërë. Mos ta përçomi mesazhin që gjithçka këtu është e dyfishtë ose nuk është e dyfishtë, nuk është ajo puna jonë ne i përdorim faktet se si na ka dhen sekretariati dhe ju lutem përdorni ato sepse unë e vrenjta disa herë që thatë të dyfishta apo të trefishta... nuk është në rregull ajo d.m.th pa i ditur të dhënat vetëm po marrim një paragjykim, ju kisha lutur vetëm që të i respektoni ato numra, sekretariati na ka dhen numrat dhe na kanë japur afatet e veta të cilat unë them që janë jashtë afatit sepse është dashur me u automatizuar ky proces si ka kërkuar sekretariati në planin vjetor, ata e kanë kërkuar këtë por KQZ-ja nuk e ka votuar atë. Kështu që çdo vendim duhet që secili me i marr pasojat e veta.

Valdete Daka: Faleminderit për sqarimin z.Rama, unë vetëm ju referova asaj që na ka dërguar sekretariati, ju lexojë fjalitë që na i ka dërguar sekretariati unë nuk e shpika vetë sepse vazhdimisht po rrini gati për të me gjetur ndonjë gabim timin. Gjithashtu numri i aplikuarve 174.258 në fund mund

të pësoj ndryshime, për shkaqe që pas vlerësimit të kriterëve shërbimet profesionale SKQA-ës fillojnë pastrimin e të dhënave nga rastet e dyfishimeve sepse ka raste të tilla ku një aplikues ka dërguar më shumë se një aplikacion për regjistrim. Unë vetëm këtë e thash sepse vetë sekretariati disa herë është duke na e potencuar që kemi raste të tilla.

Sami Hamiti: Për korrektësi sepse unë u mundova pikërisht që KQZ-ja dhe sekretariati të jenë më të kapshëm edhe për opinionin dhe më të saktë, është e vërtetë se ne mundemi të thojmë që kemi raport që janë preliminare, janë shifra të cilat japin aplikacione të dyfishta dhe të trefishta ne mundemi me than çfarë të dojë por duhet që të e konstatojmë atë. Unë pyeta aty ku është bërë zotësia juridike 63.000 a i keni a i keni pastruar nga aplikacionet të dyfishta apo jo, prandaj unë thash që të gjitha email-at të hynë në sistem, kemi aplikacion që ka aplikuar për të 2 herë dhe ju ka bërë zotësia juridike, saktë me i lanë që janë të dhëna preliminare dhe me hy sa më shpejt që të i permirwsoni në kuptimin e dyfishtë apo të trefishtë, kemi email që janë ardhur 700, aplikacione që kanë ardhur nga i njëjti email. Sigurisht që bijën poshtë sepse këto janë të dhëna që kanë ardhur nga sekretariati, nga shërbimi votues. Prandaj saktë të voton ai që ka të drejtë, ju e keni një punë që është mirë që deri nesër më i pastruar të gjitha email-at dhe pastaj që ti filloni 2 proceset tjera, çdo kush që ka të drejtë të mos i mohohet e drejta dhe çdo kush që nuk ka të drejtë të mos i lejojmë që të votojnë.

Sami Kurteshi: Tani dëgjova që nga një email kanë ardhur kaq shumë aplikacione, kjo është një çështje interesante dhe unë mendoj që sekretariati duhet ta ketë parasysh adresën e tij nëse është një adresë më 800 aplikacione të ju jepet eksperteve, policës së Kosovës që të shihet së cila është ajo adresë dhe çfarë ka ndodhur, sepse unë mënoj që kjo veç i tejkalon ato kornizat bile edhe shpirt gjerat që një familje mundet të i ketë 5,6,10 aplikacione por e kanë të njëjtën adresë dhe të njëjtin mbiemër, por kur numri shkon në 700,800 apo 100 unë mendoj që kjo tani është vetëm detyrë që duhet të verifikohet ndryshe.

Arjanit Elshani: U tha shumëçka lidhur më këtë raportim të aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, lidhur më shifrat dhe me faktin që ka dyfishime apo trefishime, ato si numra që realisht duhet të i referohemi si KQZ janë numra që janë të confirmimit të aplikacioneve për regjistrim, d.m.th deri me tani të gjitha atyre i kemi 36.685 aplikikus që i janë përgjigjur thirrjeve, duke u bazuar në vendimin e KQZ-ës që i kemi marrur këtu të gjithë bashkërisht, mendoj që këto janë shifrat ku duhet të bazohemi, shifrat tjera që janë të luhatshme për faktin se duhet të verifikohen dokumentacioni i tyre, një nga çështjet që më brengosi është shifra prej 63% e aplikacioneve që janë refuzuar realisht kanë pasur vetëm aplikacione nuk kanë pasur dokument të letërnjoftim apo pasaportë që e ka vërtetuar që është po ai person. Kjo, besoj që është brengose, që veçanërisht mendoj që pas verifikimit, pas përfundimit të këtij procesit të thirrjeve që behet për aplikuesit jashtë vendit mënoj që këto

aplikacione duhet të trajtohen duhet të telefonohen, të shihet së kush qëndron prapa atyre aplikacioneve dhe kush ka dorëzuar në emër të kujt ato aplikacione pasi ka ardhur në KQZ meqenëse, 63%. Është një shifër që brenda ati 10.000 i bije që janë diku rreth 6300 persona të cilat janë dorëzuar në KQZ dhe të cilët ne nuk e dimë se kush qëndron prapa tyre, a qëndron realisht ndonjë person që vërtet ka dashur që të aplikoi apo qëndron ndonjë organizatë në qoftë politike apo jo politike që tenton që të regjistroi aplikues për votim jashtë vendit. Edhe njëherë: 36.000 që është duke shkuar, 80% të atyre që vërtetojnë zotësinë juridike besojë që është shifër të ë e cila mundemi të bazohemi realisht dhe jo të bazohemi në këto shifra ky e dimë që ka dyfishime, e dimë secili nga ne që kemi pasur aplikues të trefishtë se për shkaqe të problemeve teknike.

Sami Kurteshi: E përmendi një shifër ku tha 63% por unë nuk e kam këtë raport ku tregon, nëse mundeni të më sqaroni, okej tash është në rregull...

Valdete Daka: Ndoshta kishte me qenë më mirë që shërbimi të na i jep më hollësisht këto informata sepse këtë faktin më 700-800 emali unë nuk e di, kështu që le të na i jep shërbimi këto shënime ma hollësisht me qenë se kemi shumë pyetje. Në qoftë se pajtoheni më vazhdua më aktivitete të ZRPP-ës, nëse nuk ka më ndonjë pyetje.

4.Aktivitetet e ZRPPC-së

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit për tërheqjen e shortit për radhitje në Fletvotim:

Vll Buleshkaj: Pika e parë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi i udhëzuesit për tërheqjen e shortit radhitjen në flete votim, ashtu siç të gjithë nga ne e dimë pas certifikimit të partive politike apo subjekteve politike që kandidojn për zgjedhje, vije koha kur organizohet një ngjarje dhe secili subjekt politikë e tërheq numrin e vetë rendor i cili do të përdoret në fletëvotim, kjo ngjarje që vlen të theksohet është një nga kompetencat shumë specifike e cila kryetarja e KQZ-ës e monitoron dhe siguron për rregullsinë e saj ndërsa përkrahët nga zyra teknikisht për realizimin e ngjarjes e kemi si praktik por edhe është kërkesë ligjore që të votohet një udhëzues i cili e bënë më transparent punën së çfarë bëhet atë ditë kur tërhiqen ata numra të partive politike garuese. Ky udhëzues, është predikuar pak sa i përket punës së numrave të subjekteve politike të cilat më rregullën e KQZ-ës për fletëvotim është vendosur që të fillojnë gjithmonë nga numri 111 në mënyrë që mos të përzihen numrat e subjekteve politike me numrat e kandidatëve të subjekteve politike, nëse keni ndonjë pyetje ma specifike për këtë udhëzues do të mundohemi që të jepmi përgjigje apo sqarim, por është 97% e njëjtë sikur herën e kaluar vetëm i përmirësuar me data dhe disa gjëra minimale që kanë pasur kërkesa.

Valdete Daka: Faleminderit. A ka dikush pyetje?

Ibrahim Selmanaj: Faleminderit Yll për sqarimin, vetëm e kisha qartësuar pikën C, sepse zëdhënësi zakonisht e ka moderuar tërheqjen e shortit dhe i takon edhe ashtu vetëm e kisha qartësuar.

Arjanit Elshani: Ligjërisht zëdhënësi nuk ka përgjegjësi për të moderuar por gjithmonë ka qenë si praktik që ju ka dhen detyrë shtesë për ta përfunduar, e kjo as në këtë formë e asnjë formë tjetër nuk e pengon zëdhënësin për ta kryer këtë detyrë.

Valdete Daka: Atëherë kush është për këtë ndryshim? Miratohet...

2.Shqyrimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

Yll Buleshkaj: Rekomandimin që kemi dhen për akreditimin të vëzhgueseve të 8 entiteteve, rekomandimet janë që të gjitha dokumentacioni është shqyrtuar për këto rekomandime që kemi dhen, kemi rekomanduar që për OJQ vendore, QPA-ve të akreditohen 166 vëzhgues, për OJQ vendore, QKBN të akreditohen 84 vëzhgues për median vendore ATV 24 vëzhgues, OJQ vendore IDK 45 vëzhgues edhe për OJQ tjetër 22 vëzhgues, për media ndërkombëtare 4 vëzhgues, për OJQ NDI 21 vëzhgues si dhe për subjektin politik PDK më 71 vëzhgues. S'i total, janë 437 vëzhgues dhe duke i shtuar dhe ata të herës se kaluar behën 480 vëzhgues.

Alim Rama: Kam një pyetje: NDI- a, janë vëzhgues ndërkombëtar...?

Yll Buleshkaj: Ajo është organizatë ndërkombëtare edhe pse vëzhguesit janë vendor shumica nga ta ne i akreditojmë si organizatë ndërkombëtare.

Valdete Daka: Përderisa janë nën ombrellën e tyre, janë vëzhgues të tyre.

Arjanit Elshani: A keni arritur më i përgatitë çështjet teknike apo përkthimin e atij formularit në anglisht.

Valdete Daka: Atëherë ndoshta kishte me qenë mirë edhe me ju njoftuar se ndërkohë ka arritur edhe një ekip i eksperteve jo i vëzhguesve ndërkombëtar siç i kemi pasur në zgjedhjet e kaluara pra është një ekip i eksperteve zgjedhor nga BE-ja, të cilët do të jenë këtu dhe të cilët tani më kanë filluar monitorimin e KQZ-ës para procesit zgjedhor, gjatë ditës së zgjedhjeve dhe pas ditës së zgjedhjeve...Mirëpo, të njëjtit për shkak të situatës me pandemi nuk kanë mundur të dërgojini misionin ashtu siç e kemi pasur zakonisht herëve tjera por do të jetë një ekip i eksperteve të cilët në fund do të kenë edhe një raport në fund të marsit lidhur me atë që ka ndodhur gjatë këtyre zgjedhjeve. Atëherë vazhdojmë më rekomandimin e zyrës, e ajo është që të aprovohet akreditimi i vëzhguesve: "Qendra për politika dhe avokim 166 vëzhgues". Kush është për? Akreditohen...

Kush është për akreditimin 84 e qendrës kosovare për bashkëpunim ndërkombëtar? Kush është për? Akreditohe...

Kush është për që të akreditohe 24 vëzhgues të medias vendore ATV? Akreditohe...

Kush është për që të akreditohe 45 vëzhgues të Institutit Demokratik të Kosovës KDI? Akreditohe...

Kush është për që të akreditohe 22 vëzhgues të OJQ-ës ... ? Akreditohe...

Kush është për që të akreditohe 4 vëzhgues të medias ndërkombëtare ... ? Akreditohe...

Kush është për që të akreditohe 21 vëzhgues NDI? Akreditohe...

Kush është për që të akreditohe 71 vëzhgues të subjektit politik PDK? Akreditohe...

Ju lutem që të i vendosin në Ueb-faqe menjëherë.

Yll Buleshkaj: Unë, vetëm desha të theksoj që java e ardhshme është java e fundit për aplikime për vëzhgues nga OJQ vendore dhe patriotike deri të premtën, ndërsa deri të hënën kanë të drejtë për aplikim organizatat e huaja, mediat e huaja etj. Për organizatat e huaja por edhe për ato vendore të cilat po kanë vështirësi të vijën fizikisht i pranojmë të skanuar dokumentet, ndërsa kur po e marrim vendimin po i marrim edhe kopjet fizike, arsye është që të e zvogëlojmë sa më shumë kontaktin fizik. Të gjitha OJQ-të apo mediave të cilave po ja akreditojmë vëzhguesit për shkaqe që nuk është përfunduar ende kontrata për prodhim të dokumenteve të identifikimit, ne ja dërgojmë se bashku me vendim dhe listën e vulosur të gjithë vëzhguesve të cilët mund të përdoren për qasje ku do që është e mundur në hapësirat ku organizohen zgjedhjet .

Valdete Daka: Është mirë që edhe një herë të specifikohet se data e fundit për aplikim të akreditimit të vëzhguesve për subjekte politike është data 5, dhe OJQ vendore, ndërsa për ndërkombëtare më 8 shkurt. Atëherë vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-ës, këshilli për operacione zgjedhore.

5.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për bartjen e votuesve nga QV 2133b - shkolla fillore "Dëshmorët e Qyqavicës" në fshatin Dashec në QV 2132 - shkolla fillore "Pavarësia" në fshatin Baks të komunës së Skenderajt:

Alim Rama: Në mbledhjen KOZ-it më datën 25, këshilli ka shqyrtuar rekomandimin e sekretariatit për bartjen e qendrës së votimit 2133/B shkolla fillore 'Dëshmoret e Qyqavic në fshatin Dashefsë, qendër të votimit 2132 shkolla fillore ' Pavarësia' në fshatin Bakës të komunës së Skenderajt dhe kjo ndodh

vetëm për këto zgjedhje për shkaqe të vërshimeve që kanë ndodhur atje dhe shkolla nuk është e përdorshme dhe nuk ka me qenë gati për këto zgjedhje, dhe këshilli i kërkon KQZ-ës që të aprovohet kjo lëvizja për këto zgjedhje.

Valdete Daka: Atëherë është për këtë rekomandim? Me siguri që zyrta ri jonë atje do ti bëjë informacionet. Miratohet...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit dhe zëvendësimeve për anëtar të KKZ-ve sipas komunave përkatëse:

Alim Rama: Edhe sekretariati është udhëzuar që të bëjë informacionin publikë dhe të komunikojë më banoret dhe votuesit në këtë vend. Po ashtu në të njëjtën mbledhje KOZ-i ne afatin e fundit ligjor ka trajtuar miratimin dhe procesimin e zëvendësimit për anëtarët të KKZ-ve sipas komunave përkatës, e keni listën e KKZ-ve që do të zëvendësohen dhe ne mënyrë unanime KOZ-i i rekomandon KQZ-ës për aprovim.

Valdete Daka: Kush është për? Miratohet...

Pika tjera janë shtyrë për mbledhjen e ardhshme, këshilli për buxhet dhe financa.

Sami Hamiti: Jemi dekoduar që të 5 anëtarët, pasi që është një material voluminoz që të trajtojmë deri nesër, kështu që e kemi shtyrë për nesër ne ora 11:00....

Valdete Daka: Faleminderit...

6.Të ndryshme !